UNIONE ARBERIA
LIDHJA ARBËRIA

GAZETA

EDITORE UNIONE "ARBERIA"
BOTUESI LIDHJA " ARBËRIA"

REDAZIONE *REDAKSIA*
Annunziata Bua
Francesca Prezzo
Silvia Tocci
Ernesto Trotta
Daniela Zanfini

GRAFICA *GRAFIKA*
Silvia Tocci
Daniela Zanfini

PERIODICO BILINGUE DI INFORMAZIONE - ANNO IV - Nr. 6 - FEBBRAIO - MARZO 2015

GAZETA NJOFTIMI DYGJUHËSHE - VITI IV - Nr. 6 FJAVAR - MARS 2015

Sezioni *Dega* — Sommario — *Përmbledhje*

Favole	La metà del gallo	*Gjimsa e gjelit*	*2*
Përrallëza	Costantino il piccolo	*Kostandini i vogëlith*	*3*
	Biancaneve	*Borabardhë*	*4*
Poesie *Poezia*	Siamo tutti ugualli	*Jemi gjithë hualle*	*5*
	Bruciavano i nostri sogni	*Djegia e ëndrrave*	*5*
	Ispirazione involontaria!	*Frymëzim i padashur!*	6
	La numero 1 delle fattucchiere! Amelia in biblioteca.	*E para ka magarët!* *Melja te biblioteka.*	*7*
	Dormire che fatica!	*Të fjëjturit çë lodhje!*	*8*
Fumetti	Un'attesa stressante!	*Një pritje çë të lodhën!*	*9*
Vizatimore	Una vita da papero - Riflesso condizionato	*Gjellë paprish - Refleks i kondicionuar*	*10*
	Minni in vacanza nel bosco	*Minni në pushim te voshku*	*11*
	Il lampadario	*Llambadhari*	*12*
	Una sola passione - L'affare	*Një pasion të vetëm - Biznesi*	*13*
	Coltello mannaia	*Thikëza mahjere*	*14*
Filastrocche *Parastroqe*	Ciondolino di tamburello	*Nxhinxhinelez tamburini*	*14*
	Piante e Fiori	*Qanda dhe Lulja*	*15*
Crucipuzzle - Crucintarsio *Fjalëkriq - Kërko fjalët*	Indumenti e biancheria	*Mbrola ngrah dhe për shpinë*	*16*
	Utensili casalinghi	*Vegla për shpinë*	*17*

INDIRIZZI ***ADRESAT***

SEDE CENTRALE
Piazza Crispi - 87069 San Demetrio Corone (CS)
Tel.: 0984/ 956966 - Fax: 0984/
E-mail: posta@unionearberia.it

SEDI DECENTRATE
Piazza della Libertà - 87060 San Cosmo Albanese (CS)
Piazza Marconi - 87060 San Giorgio Albanese (CS)
Largo Trapesa - 87048 Santa Sofia d'Epiro (CS)
Via Croinusevet - 87060 Vaccarizzo Albanese (CS)

www.unionearberia.it www.comune.sandemetriocorone.cs.it www.comune.sancosmoalbanese.cs.it
sangiorgioalbanese.asmenet.it santasofiadepiro.asmenet.it vaccarizzoalbanese.asmenet.it
www.facebook.com/sportellolinguistico.unionearberia

GJIMSA E GJELIT

Një herë *ishin dy ndrikulla e rijin tek hjea, shkoi një lëtirë çë shit ca gjela.*

Njera ndrikull i tha: " Sa e do një gjel?". Ai rrispëndoi: " E dua dy llira!".

Ndrikulla: "Ooohhh! Dy llira! U kam vet një….si kam bënj?".

Rrispëndoi jetra ndrikull: " edhe u kam vet një llirë!... e di çë do të bëmi, i kuqarmi kështu bëmi dy llira e bjemi gjelin". E kështu bënë. Ndrikulla ç'ish më e mirë mbajti gjelin dhe e rriti. Kur gjeli u bë i madh zu e vate te një kashtjel ç'ish atje afër, këtu ish një kok çë dërtoni për rrexhinën, e gjeli i thoni: "kok bukuri kok, çë bën rrexhina? E çë bën rregji për rrexhinën?"

Koku sa t'e ngudhirni i shtini një grusht krip, gjeli vullarni e veni mbi sënduqit ku rregji mbani soll-det e hani, njera çë mbjoin gushën. Kur u mbjidhi te ndrikulla ç'e kish rritur i thoni: "Oj ndrì, hap një llunxull të bardhë e të bukur!" Ndrikulla mbjatu mirr llunxullin më të bukur e hapni mbi shtra-tit e gjeli nxierr sollda ka gryka. Ndrikulla qëndroi e i tha: "popopo, ku vajta e i mora gjithë këta sollda?"

Rrispëndoi gjeli: " i mora tek rregji e nani çë di ku i mban vete ngaherë!".

Kur vate njetër herë, ndrikulla i vu kolë tek pendet sa t'i sillni më shumë sollda. Një ditë ndrikulla dojë të dini sa sollda kish, vate muar hua menxën tek jetra ndrikull.

Jetra ndrikull ç'ish më e ligë, parë sa t'ia jip i vu kolen tek fundi i menxës ".

Kur ndrikulla e mirë ja pruri ajo pa se kish masur sollda e dish të dini ku i kish marrë gjithë ata soll-da.

Ndrikulla e mirë kur pa se nëng mund t'ia negoni i rrëfyeti fillarin. Allura ndrikulla e ligë i tha:

"Ndëse është kështu gjelin e mbami një javë për një, kështu më sillen edhe mua sollda".

Gjeli vate te kastjeli e kur u mbjodh tek ndrikulla e ligë i tha: "hap llunxullin më të bukur!".

Ndrikulla mbjatu hapu llunxullin, por gjelli mirë të nxirë sollda ka gryka i bëri një gëlas.

Ndrikulla u nguetar e tha: "pse asana sollda e mua një gëlas? Nani të vras!"

Gjeli , i shkreti, vate tek ndrikulla e mirë e i kundarti gjithë fillarin e doni vrarë ka ajo, por ndri-kullës i nditnej keq e nëng do t'e vrit.

Gjeli i tha: " ti vritmi e mos u trëmb, se pra u bëhem njëter herë gjel!".

Kështu ndrikulla e mirë vrau gjelin e muartin një gjysmë për një. Ndrikulla e ligë gjymsën e saj e hëngri, ajo e mira e vloi e, ajo gjymsë u bë gjel. Ky gjel zu e vate njëter herë tek kastjelli rregjit e prir tek ndrikulla me sollda, keshtu ndrikulla e mirë u bëgat.

KOSTANDINI I VOGËLITH

Një herë ish *një jëmë shumë e mirë e kish dy bil, një djalë dhe një vajzë. Djalit ia thojën Kostandin i vogëlith. Ky u martua dhe muar një nuse të mire. Tri ditë dhëndërr ish dhe regji e thërriti sulldat. Kostandini parë të nisej u puth me të jëmen, me të motrën dhe nuses, së bukurës, i muari unazën ka gjishti e i tha: -Prit nëntë vjet, nëntë muaj dhe nëntë ditë, mos u nëng mbjedhem ti martohu!*

Muari kalin e vate sulldat.

Nusja priti e priti. Shkuan nëntë vjet, nëntë muaj e nëntë ditë e kostandini i vogëlith nëng u mbjodh. Kështu ajo gjejti njëtër dhëndërr e kish të vëni kurorë.

Naten Kostandinit nëng mund t'i zënej gjumi e shërtoni, shërtoni fortë.

-Kush ësht'e shërton? – tha rregji.

- Kostandini i vogëlith – i thanë të tjerat suldet.

- Ç'ke e shërton? – i tha rregji.

- Sot martohet nusja ime. Shkuan nëntë vjet, nëntë muaj e nëntë ditë, sot bukurza vë kurorë me njëtër burrë.

- Ec tek ajo! – i tha rregji – kallaru tek stalet e zgjidh më të mirin kalj. Mirr të shpejtin si petrit.

Kostandini i vogëlith muari të shpejtin si petri, u nis dhe vate si era. Udhë e udhë ju përpoq i jati:

- ku je vete ti zoti pjak?

- Vet'e gramisem. Sot martohët ime re, nusja e Kostandinit.

- Priru praptë zoti tatë , se jam u Kostandini e jam e mbjidhen mbë shpi.

Ju përpoq e jëma: ku je vete ti zonja pjake?

- Vet'e gramisem. Sot martohet ime re, nusja e Kostandinit.

- Priru praptë zonjë mëmë , se jam u Kostandini e jam e mbjidhen mbë shpi.

- Ju përpoq e motra dhe i pyeti: ku je vete ti vashëz?

- Vet'e gramisem. Sot martohet ime kunatë, nusja e Kostandinit.

- Priru praptë motra ime, se jam u Kostandini e jam e mbjidhen mbë shpi.

Kur arrëvoi ndë katund, vate përpara derës së Qishës: -Bëmni llarg, ju buljer, se jam u kurora e parë!

Muar unazën e ja dha nuses. Ajo, sa pa unazën, mbjatu e njohu se ai ish Kostandini e tha:

- Ky është Kostandini im, mos nëng më kini besë njo kjo është kurora e parë.

BORABARDHË

Një herë ish *një rrexhinë e ish'e rigamarnej një llunxull. Tue rruajtur si binej borë, i vate gilpëra tek gjishti dhe i duall një pikë gjak të madhe e bëri të kuq llunxuallin. E penxoj: " ndëse kisha një bilë të bardhë si bora e të kuqe si ky llunxull e thërrisja "Borabardhë". Kështu, kur u le vajza me faqen e bardhë dhe e kuqe e thërriti Borabardhë. Mbjatu rrexhina vdiq, vajza dhe pringjipi qëndruan vet. Shkoi mot dhe pringjipi u martua me njeter rrexhinë, kjo ish e ligë e do të duhej më e bukura e dheu, veni tek speqi e i thonej: -Speq, speq, kush është më e bukur , u o Borabardha?*

Një ditë speqi i rispëndoi: - Ti je e bukur, por Borabardha është më e bukur!



Ajo u nguetar e çajti speqin, thërriti një kaçatur e i tha:

- Qellë Borabardhën te voshku, vrite e siellëm zëmrën.

Kaçaturit i ndieti keq, muar Borabardhën e e shehu tek një shpiarelezë ku rrijn shtatë nënulliqra, pra vrau një dhie e zëmrën ja suall rrexhinës së ligë. Ajo sa e pa tha:

- kjo nëng është zëmra Borabardhës! E e shtu jasht.

Borabardhës i vinej u e hëngri tek shtatë taluret e nanulliqravet, piti te shtatë qelqra e pra vate e fjëjti. Kur u mbjodhtin nanulliqrat thojin:

- kush hëngri tek taluri im? - kush piti tek qelqi im? - kush muar bukën tim?

E gjithë fjisjin…vanë te shtrati e çuan Borabardhën çë fjënej.

- Sa e bukur është! – than.

- Nëng e zgjomi, mos trëmbet!

Menatet kur Borabardha u zgjua rrëfyeti gjithëse nanulliqravet, atyrve i ndieti keq dhe e mbajtin bashkë me ato. Kur rrexhina e ligë xu se Borabardhë rrinej te shpiarelëza e nanulliqravet, beri një magji: u bë magarë, mbjoi një çistë me molla dhe i vu një të vellenatur dhe e qelli tek shpiarelja e nanulliqravet. Borarabardha u zgjua pa çistën pjot me ata molla të bukura, muarri një e i hëngri, dhe gjithënjëherje ra mbë truall. Kur u mbjodhtin nanulliqrat e e çuan të vdekur u helmuan e qajtin, e thanë:

- e vëmi mbrënda tek një tavut qelqi, kështu e shohmi ngaherë çë duami.

Një ditë ka atej shkoi një pringjip, sa pa Borabardhën qëndroi i zënë ka bukuria e saj, e ngau me drurin e fatartur dhe ajo mbjatu u zgjua. Nanulliqrat qenë gjithë kutjend dhe pringjipi e Borabardhën u martuan e bënë festë.

Jemi gjithë hualle

Vemi gjithë bashkë
Ecmi gjithë dheun
Qellmi gjithparu një cikë dritë
E dhe atyrve çë gjithë i harruen
Na i thomi se janë vëllezër tanë
Jemi te dheu
Jemi shumë raca
Ma mosnjera është më e mira se jetra
Kur gjithë arrvuen e kapirtin
Mënd thomi se jemi të kështe
Jemi të bardhë
Jemi të zi
Jemi gjithë hualle
Qellmi te dheu një fjalë të mirë
Udhet te dheu janë pjot
Me gjindë të vënë ka një anë
Kriatura çë nëng kanë një shpi
Kriatura çë nëng din ku rrin
Kuqaremi gjithë bashkë
Kuqaremi gjithë duert
Bëmi për dheun një rrotë e madhë
E ndëmest i lëremi shkrajtur
Jemi
Na jemi gjithë hualle.

Siamo tutti uguali

Andiamo tutti insieme
Giriamo per il mondo
Portiamo dappertutto un po' di luce
Anche a quelle persone dimenticate da tutti
Diciamo loro che sono nostri fratelli
Siamo nel mondo
Siamo molteplici razze
Ma nessuna è migliore dell'altra
Quando tutti arriveranno a capirlo
Potremo dire di essere persone
Siamo bianchi
Siamo neri
Siamo uguali
Portiamo nel modo una buona parola
Le strade del mondo sono piene
Di persone messe da parte
Bambini che non hanno casa
Bambini che non sanno dove stanno
Stiamo tutti insieme
Uniamo le nostre mani
Facciamo un grande cerchio attorno al Mondo
E in mezzo lasciamo scritto
"Siamo
Noi siamo tutti uguali"

Franco Curti

Djegia e ëndrrave

Në zjarrin e ditëve të shkuara
digjeshin ëndrrat tona
të luftrave pa gjak.

Për ndë udhë të verës
luajim patâ-patâ
mu në vapë
e mosnjeri s'doj të vdiq.

Sot vdesmi. Larg.
Të ndrydhur si mizat
në hon.

Me motin
me motin dërmohet
fuqia për luftë.

Bruciavano i nostri sogni

Nel fuoco dei giorni passati
bruciavano i nostri sogni
di guerre senza sangue

Per le strade d'estate
giocavamo a patâ-patâ
dentro l'afa
e nessuno voleva morire


Oggi moriamo. Lontani.
Schiacciati come mosche
contro il baratro

Col tempo
col tempo che si sgretola
la forza di lottare

Carmine Abate


I BIS BIS
FRYMËZIM I PADASHUR
Toskanë 1307...
Nëng di çë kam bënj, i dashur miku im
CHOMP, CHOMP...
Doja të shkruaja gjë të re, por nëng më vjen nxë farëgjë
CHOMP CHOMP
Asnjë ëmër! Ti si e thërrisja… çë të thom… për shembull një komedi?
Të zezë! Ahhhh… Këta rrush është të zezë! Si… thoja, rrush e vresht?
E çova!!!
FUNDI


E para ka magarët
Melja te biblioteka
Magjia
Wao! Këtu fjitet për magarën Menucë!
Ohhh!
Kushedi ndë çonj edhe formulën magjike e saj
Magia
Ëëhh…
E çova!!!
Ehhhh!!!
Më pëlqen shumë dhe më duhet e mirë!
FUNDI


Të fjejturit
ZZZZZZ
Çë lodhje!
Udhe-udhë
Pas kësaj ngjitje arrëvuam!
Slll..ZZZ..
ZZZZ..
AAARG!
Ng'e kam besë! Ra kështu forte e ai… fjë kutjend!
RONF..FI..
AAAH!
FUNDI


Një pritje çë të lodhën
PAPEROTTO &CO.
Ti nëng qeve fare i mirë!
Ti nëng bëre shërbisa të mira!
Andajna mos prit fa-regjë !
AAARGH!!
Ufff...çë lodhje të presh!
FUNDI


Gjellë paprish
Refleks i kondicionuar
Si kam ju e thom? Nëng është ky numri çë duani juuuu
NOOOOOO
JO E JOOOOO! Nëng ë shpia PAPERUQ!!! Ju e the jetrën here!
Ndëse ky më çan kryet njëtër here, u …
E nani thërresmi një adhazma, e i jami një mijë eurosh!
PRIIN
Shpia...
Joooo! Nëng ë kjo shpia çë duani ju!!!
Manea! Numri i paperuqit nëng është ky! Një mijë eurosh ja jami…
FUNDI


MINNI
në pushim
tek voshku
Ah… çë friskur ç'është tek voshku!
Një grutë... mund të kërkoj gjë
Më thanë se tek ky voshk janë orqit!
AAARGH!
këtu është pjotë me milingonaaa
GRAT
GRATT
FUNDI


Mikro
Mis
Llambadhari
Njo,ky është më i bukuri?
E ky ?
Jo, jo, jo
Ky është shumë i vikërr
Dua atë!
E zgjodhe të mirë! Ky është llampadhari çë bënë më dritë!
FUNDI


Një pasion të vetëm
Biznes
Ehi, Paper i madh! Pse nëng na e thua cila qe biznesi e fundit çë bëre
Shoqata e miliardëve
Ju e thom vet ndëse më paguani verën çë pi!
Mirë!
Ehi, ganjù
Pas çë pieti shumë verë
Oj paper i madh! Nani thuaj cili qe biznesie fundit çë bëre?
Njo, është kjo çë bëra njëmend!
FUNDI

Parastroqe Filastrocche


Thikëzë mahjere, Ku je?	Coltello mannaia dove sei?
Jam aprapa kucërit.	Sono dietro il ceppo.
E kucëri ku është?	Il ceppo dov'è?
E dogji zjarri.	Lo ha bruciato il fuoco.
E zjarri ku është?	Il fuoco dov'è?
E shujti ujit.	Lo ha spento il fiume.
E ujit ku është?	Il fiume dov'è?
E pitin qet.	Lo hanno bevuto i buoi.
E qetë ku janë?	I buoi dove sono?
Vane e shitin melët.	Sono andati a trebbiare il miglio.
E melët ku është?	Il miglio dov'è?
E hëngri zogu.	L'ha mangiato l'uccello.
E zogu ku është?	L'uccello dov'è?
Vate mbi ferrit.	È sul roveto.
E ferri ku është?	Il roveto dov'è?
E hëngri dhia.	Lo ha mangiato la capra.
E dhia ku është?	La capra dov'è?
E hëngri ulku!	L'ha mangiata il lupo.
E ulku ku është?	Il lupo dov'è?
Vate mbë qishë,	È andato in chiesa,
dualli pa këmishë.	ed è uscito senza camicia.
Vate mbë krua,	È andato alla fontana,
çoi një grua	ha trovato una donna
e rrëmbei me një thua,	l'ha afferrata con un artiglio,
e e shtu ndë një përrua!	e l'ha scaraventata in un burrone.

Nxhinxhinelez tumbarini,	Ciondolino di tamburello,
je si mollez te jardini;	sei come una piccola mela nel giardino;
je si mollez, je si dardh,	sei come una piccola mela,sei come una pera,
je si një pllumb i bardh;	sei come una colomba bianca;
je si një kumbull, je si një sheg	sei come una prugna, sei come un melograno
je si gërshia ndë një deg.	sei come la cieligia sul ramo.

...qanda dhe lulja


Crucipuzzle

H	A	M	O	M	I	L	T	M	Ë	N	Z	A
O	T	R	Ë	N	D	A	F	I	L	J	A	O
M	A	N	U	S	H	A	Q	J	A	E	K	R
M	M	D	P	O	R	T	A	G	A	L	A	A
S	A	A	G	K	I	G	T	T	P	U	L	P
P	R	F	A	G	A	R	O	F	U	L	L	I
A	Ë	N	K	L	I	A	I	S	B	E	I	T
R	Z	A	L	S	C	H	G	H	W	D	P	I
T	A	Ë	I	I	T	M	T	E	S	I	S	O
A	M	L	R	I	Q	J	A	G	K	E	I	W
P	S	R	H	H	U	B	K	A	L	L	I	U
M	O	K	U	L	P	R	A	H	I	L	Q	I
G	Ë	R	S	H	I	U	U	L	L	I	R	I



- Sa i lig është: do se maçja rri e e gjegjen!!!


Apiti (abete); **Trëndafilja** (rosa); **Dhria** (vite); **Ulliri** (ulivo); **Kulpra** (vitalba); **Gërshiu** (ciliegio); **Hithi** (ortica); **Shega** (melograno); **Hamomilt** (camomilla); **Dafna** (alloro); **Riqja** (erica); **Qupi** (pioppo); **Mëllaga** (malva); **Kalliu** (spiga); **Mënza** (gelso); **Garofulli** (garofano); **Gorrica** (pero selvatico); **Manushaqja** (violetta); **Marëza** (corbezzolo); **Lisi** (quercia); **Portagala** (arancio); **Hilqi** (leccio); **Sparta** (ginestra); **Kallipsi** (eucalipto); **Luledielli** (girasole).



- Oh! Ç'është i bukur ky lisi me këta arra të mbëdhenj
- Xa! Njo çë arrë e madhe dhe e bukur
- e çami!!!
Ahhh mëma ime! Kush është ky?

Kërko fjalët Crucintarsio

***MBROLA NGRAH DHE PËR SHPINË* - INDUMENTI E BIANCHERIA**





- Presmi telenovelën sa t'ju mbami mend të nxirni gjë ka frigorifri t'e hani sonde...

HORIZONTAL

3. Camicia **5.** Coperta **7.** Tovagliolo **10.** Pigiama **12.** Calze **13.** Grembiule **14.** Bretella

VERTIKAL

1. Berretto **2.** Fazzoletto **4.** Plaid **6.** Sottoveste **8.** Borsalino **9.** Cravatta **11.** Cintura

MANDA STIAVUKU TALLJANJA SKAMANDILI KËMISHA SKOLA PALACA TRAKOLLA
LINJA KALLUCJET VANDIZINI SUTANINI BREZI SHAPKA



SPORTI MBJEDH... ATO Ç' E BËJNË... DHE ATO Ç'E DIOVASËNJNË!!!

Crucipuzzle

...vegla për shpinë

D	J	E	P	I	K	H	E	K	U	R	U	Z	I	T
T	R	I	P	T	I	A	D	U	A	Q	I	T	V	U
R	R	O	G	J	E	A	N	G	Ë	L	P	Ë	R	A
M	A	G	J	A	S	H	P	O	R	T	A	I	A	R
Q	L	L	O	N	X	H	E	L	J	A	T	X	Z	A
P	Ë	R	P	R	U	S	H	I	F	A	S	H	H	T
E	Z	N	S	H	O	S	H	I	K	K	O	P	I	K
A	R	G	A	L	J	A	Q	G	K	S	H	O	E	Ë
D	O	K	A	N	I	Q	E	P	A	O	M	Ç	R	S
F	I	S	H	E	L	J	A	U	R	U	E	J	I	I
G	Ë	R	S	H	E	U	N	K	T	E	L	A	R	S
K	M	O	Q	X	K	A	S	H	U	N	I	U	W	T
Q	U	D	H	E	N	D	J	A	Ç	S	K	J	G	R
X	T	F	S	H	I	S	H	A	I	E	I	E	O	A
K	O	P	A	N	I	B	O	S	H	T	I	A	W	G



- Jot'ëmë ka të jetë këtu afër. Njo si ikënjnë zogjtë ...

Kërko Fjalët **Risolvi il crucipuzzle.**

Tripti (treppiede); **Hekuruzit** (ferri da calza); **Djepi** (culla); **Duaqit** (bisaccia); **Kanoja** (canniccio o graticcio per essiccare la frutta); **Rrogjea** (orciuolo in terracotta); **Gëlpëra** (ago); **Magja** (madia); **Shporta** (cesta); **Kashuni** (cassone); **Kësistra** (raschiatoio metallico); **Llonxhelja** (brocca); **Përprushi** (palo per rimuovere brace nel forno a legna); **Shoshi** (setaccio); **Kopi** (mestolo); **Argalja** (telaio); **Dokaniqe** (forcella); **Gërsheu** (uncinetto); **Fishelja** (fiscella da ricotta); **Boshti** (fuso); **Qudhendja** (coperchio per forno a legna); **Kopani** (battipanni); **Shisha** (scopa); **Vrazhieri** (braciere); **Kusia** (pentolone); **Poçja** (pignata); **Kufa** (cesto di paglia); **Kartuçi** (boccale); **Kati** (secchio); **Hekuri** (ferro da stiro); **Dokaniqe** (forcella); **Luga** (cucchiaio).

LIDHJA ARBËRIA









